

**Gjykata e Qarkut Prishtinë**

**KA nr.417/11**

(GJPP nr.125/10)

(PPS nr.376/09)

**25.11.2011**

Gjyqtari i EULEX-it Gianfranco Gallo, si gjyqtar i konfirmimit, në lëndën penale kundër:

**Blerim DEVOLLI**, emri i babait \_\_\_\_\_ i lindur më \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, me adresë në Rrugën \_\_\_\_\_, nr. \_\_\_\_\_, Pejë;  
**Shkelqim DEVOLLI**, emri i babait \_\_\_\_\_, i lindur më \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, me adresë në Rrugën \_\_\_\_\_, nr. \_\_\_\_\_, Pejë;  
**Ismet BOJKU**, emri i babait \_\_\_\_\_, i lindur më \_\_\_\_\_, me adresë në Rrugën \_\_\_\_\_, nr. \_\_\_\_\_, Pejë;

Të akuzuar për:

**Mashtrim**, neni 261 par.(1), (2), siç është lexuar në nenin 23 të KPK-së;  
**Lidhje të Kontratave të Dëmshme**, neni 237 par.(1), (2), sikurse është lexuar në nenin 23 të KPK-së;  
**Keqpërdorim të Besimit**, neni 269 par.(1), ku **Blerim DEVOLLI** dhe **Shkelqim DEVOLLI** gjoja kanë vepruar në ndihmë, sikurse është lexuar në nenin 25 të KPK-së;  
**Falsifikim të dokumenteve**, neni 332 par.(1) i KPK-së; lexon në lidhje me rastet e veçanta të falsifikimit të dokumenteve, neni 333, nën par.1), lexo në nenin 332, par.(3) të KPK-së; sikurse është lexuar në nenin 23 të KPK-së;  
**Krim të organizuar**, neni 274 par.(1), (3), sikurse është lexuar në nenin 23 të KPK-së;

Kundër:

**Shyqyri HAXHA**, emri i babait \_\_\_\_\_, i lindur më \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, me adresë në Rrugën \_\_\_\_\_, nr. \_\_\_\_\_, Prishtinë dhe \_\_\_\_\_, Mbretëri e Bashkuar;  
**Rexhe GJONBALAJ**, emri i babait \_\_\_\_\_, i lindur më \_\_\_\_\_, me adresë në Rrugën \_\_\_\_\_, nr. \_\_\_\_\_, Pejë;

Të akuzuar për:

**Lidhje të Kontratave të Dëmshme**, neni 237 par.(1), (2) i KPK-së;  
**Shpërdorim i Pozitës Zyrtare**, neni 339 par.(1), (2), (3) i KPK-së;  
**Keqpërdorim i Autorizimeve në Ekonomi**, neni 236 par.(1) nën par. 5) dhe par.(2) i KPK-së;

DUKE E PARË aktakuzën PPS nr.376/09, të datës 08.06.2011, dhe të paraqitur nga prokurori special i EULEX-it në gjykatë në ditën e njëjtë më 08.06.2011;

PAS konfirmimit të seancës të konfirmimit më 13.10.2011, 27.10.2011 dhe 03.11.2011, në prezencë të të gjithë të pandehurve, siç është paraqitur nga avokati i tyre mbrojtës:

**Blerim DEVOLLI** përfaqësuar nga avokati mbrojtës Virtyt Ibrahimaga dhe Benjamin Chew;

**Shkelqim DEVOLLI** përfaqësuar nga avokati mbrojtës Gani Tigani dhe Andrew Friedman;

**Ismet BOJKU** përfaqësuar nga avokatja mbrojtëse Illiriana Osmani Serreqi;

**Shyqyri HAXHA** përfaqësuar nga avokati mbrojtës Rame Gashi dhe Tahir Rrecaj;

**Rexhe GJONBALAJ** përfaqësuar nga avokati mbrojtës Blerim Prestreshi dhe Hekuran Haxhimusa;

dhe në prani të prokurorit special të EULEX-it Joachim Stollberg të Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK);

SIPAS nenit 316, par.(4) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK);

*Lëshon aktvendimin në vijim:*

---

AKTVENDIM  
MBI KONFIRMIMIN E AKTAKUZËS  
DHE PRANUESHMËRINË E PROVAVE

---

1. Aktakuza PPS nr.376/09, e datës 08.06.2011, e paraqitur në gjykatë ditën e njëjtë, duke akuzuar DEVOLLI, Shkelqim DEVOLLI, Ismet BOJKU, Shyqyri HAXHA dhe Rexhe GJONBALAJ veprat penale të sipërpërmendura më lartë, me anë të kësaj **PJESËRISHT KONFIRMOHET**.
2. Pika 3 e aktakuzës, **Keqpërdorim të Besimit**, në kundërshtim me nenin 269, par.(1) i KPK-së, lexo në lidhje me nenin 25 të KPK-së, pika 5 e aktakuzës, **Krimet të Organizuar**, në kundërshtim me nenin 274 par.(1), (3) të KPK-së, lexo në lidhje me nenin 23 të KPK-së, pikat 8 dhe 9 të aktakuzës, **Keqpërdorimi autorizimeve në ekonomi**, në kundërshtim me nenin 236, par.(1) nën parag.5) dhe par.(2) i KPK-së me anë të kësaj **HUDHET POSHTË**.
3. Pika 1 e aktakuzës, **Mashtrim**, në kundërshtim me nenin 261, par.(1), (2) sikurse lexon në nenin 23 të KPK-së, pika 2 e aktakuzës, **Lidhja e kontratave të dëmshme**, në kundërshtim me nenin 237, par.(1), (2) sikurse lexon në nenin 23 të KPK-së, pika 4 e aktakuzës, **Falsifikimi i dokumenteve**, në kundërshtim me nenin 332, par.(1) të KPK-së lexon në lidhje me **Rastet e veçanta të falsifikimit të dokumenteve**, në kundërshtim me nenin 333, nën paragrafi 1), lexo në nenin 332, par.(3) të KPK-së, sikurse lexon në nenin 23 të KPK-së, pika 6 e aktakuzës, **Lidhja e kontratave të dëmshme**, në kundërshtim me nenin 237, par.(1), (2)

të KPK-së, pikat 7 dhe 10 të aktakuzës, **Shpërdorim i detyrës zyrtare**, në kundërshtim me nenin 339, par.(1), (2), (3) CCK, me anë të këtyre **KONFIRMOHEN**.

4. Bisedat dhe porositë tekstuale të regjistruara përmes përgjimit të numrave telefonik **X**, **X**, **X** të ndërmarrë pas 27.01.2011 janë konstatuar si dëshmi e papranueshme; në momentin që aktvendimi mbi pranueshmërinë e përgjimeve bëhet i plotfuqishëm dëshmia e mësipërme do të largohet nga dosja e lëndës.
5. Të gjitha dëshmitë tjera të mbledhura gjatë hetimit nuk janë konstatuar të pa pranueshme dhe prandaj do të mbetën në dosje të lëndës.
6. Aktakuza PPS nr.376/09, e datës 08.06.2011, me tërë dosjen e lëndës dhe dëshminë e paraqitur nga prokurori special i EULEX-it do t'i dërgohet gjyqtarit të kolegjit për seancë kryesore, menjëherë pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë.

## **ARSYETIM**

### *A. Historiati procedural*

1. Më 08.06.2011, Kryesuesja e PSRK-së Isabelle Arnal dhe prokurori special i EULEX-it Joachim Stollberg dorëzuan në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë aktakuzën PPS nr.376/09, të datës 08.06.2011.
2. Pas marrjes së aktakuzës, Gjyqtari për Konfirmim vërtetoi që aktakuza i përmbushte kriteret e parapara në nenin 305, 306(2) të KPPK-së. Prandaj, seancat e konfirmimit ishin paraparë dhe mbajtur më 13.10.2011, 27.10.2011 dhe 03.11.2011.

### *B. Zbulimet nga prokuroria*

3. Në seancën e konfirmimit të mbajtur më 13.10.2011, Gjyqtari për Konfirmim shqyrtoi nëse prokuroria kishte përmbushur obligimin për zbulim sipas nenit 307 të KPPK-së. Mbrojtja e Shyqri HAXHA parashtroi që:
  - Disa deklaratave të dëshmitarëve, të propozuara nga prokurori special në aktakuzë, nuk iu ishin zbuluar mbrojtjes;
  - Dokumentet në dosjen 7 të dosjes së lëndës nuk kishin qenë të përkthyer në Shqip.
4. Sa i përket deklaratave të dëshmitarëve, ishte caktuar gjatë seancës që disa dëshmitarë të përmendur në aktakuzë nuk ishin marrë në pyetje nga prokuroria, akoma. Si e tillë, deklaratat e tyre nuk kanë qenë në posedim të prokurorisë prandaj asnjë obligim për zbulim

nuk mund të aplikohet. Deklaratat e dy dëshmitarëve iu janë siguruar mbrojtjes së Shyqëri HAXHES në seancën e datës 13.10.2011.<sup>1</sup>

5. Sa i përket dështimit të prokurorit për të përkthyer dokumentet që janë në dosjen 7, ishte vlerësuar gjatë seancës që dosja e mësipërme përmbante gjithashtu disa raporte policore dhe për këtë nga prokurori ishte kërkuar të siguroj mbrojtjes përkthimet e nevojshme.<sup>2</sup> Në seancë më 27.10.2011, mbrojtja konfirmoi që mbrojtjes iu ishin siguruar nga prokuroria përkthimet e mësipërme.<sup>3</sup>
6. Në vazhdim të sipërpërmendurës, Gjyqtari për Konfirmim vlerësoi që prokurori kishte përmbushur obligimin e zbulimit në pajtim me nenin 307 të KPPK-së.

### *C. Akuzat*

7. Aktakuza sjell akuzat e sipërpërmendura kundër të pandehurve në lidhje me rrethanat faktike në vijim:
  - Bartja e Licencës së Operatorit të Rrjetit Mobil Virtual (ORRMV) nga Dardafon LLC në Dardafon.net LLC;
  - Miratimi i kushteve financiare për Postë dhe Telekomunikacionin e Kosovës JSC (PTK) sipas marrëveshjes së MVNO ndërmjet PTK-së dhe Dardafon LLC;
  - Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes ORRMV ndërmjet PTK-së dhe kompanisë Dardafon.net LLC.
8. Në seancë më 27.10.2011 të gjithë të pandehurit nuk pranuan fajësinë nga të gjitha pikat në aktakuzë.<sup>4</sup>
9. Si pasojë, me qëllim të vendosjes në konfirmim apo hedhje të aktakuzës, Gjyqtari për Konfirmim është i detyruar të kryej vlerësimin në pajtim me nenin 316 të KPPK-së.

### *D. Vlerësimi fillestar*

10. Sipas nenit 316 par.(1) nën par.1), 2), 3), par.(2), par.(3) i KPPK-së, Gjyqtari për Konfirmim konstaton që asnjë rrethanë në ato dispozita nuk ekziston që do të parandalonte vlerësimin e mëtutjeshëm të aktakuzës.

<sup>1</sup> Procesverbal i seancës së konfirmimit, 13.10.2011, ff.4-6 (në versionin në Anglisht)

<sup>2</sup> Procesverbal i seancës së konfirmimit, 13.10.2011, f.10 (në versionin në Anglisht)

<sup>3</sup> Procesverbal i seancës së konfirmimit, 27.10.2011, f.4 (në versionin në Anglisht)

<sup>4</sup> Mospërputhjet në përkthim të aktakuzës në Gjuhën shqipe, para kohës ka qenë e qartësuar në seancë më 27.10.2011. *Shih* procesverbalin e seancës së konfirmimit, 27.10.2011.

11. Në veçanti, nuk ekzistojnë rrethanat të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale, periodha e parashkrimit nuk ka skaduar dhe nuk ka arsye të tjera për pengim të ndjekjes (neni 316 par.(1) nën par 1), 2), 3) i KPPK-së).
12. Mbrojtja e **Blerim DEVOLLI** dhe **Shkelqim DEVOLLI** dhanë fakte që aktakuza ishte parashkruar pasi që hetimi ishte iniciuar më 17.09.2009 dhe aktakuza ishte ngritur më 08.06.2011.  
Sa i përket kësaj, është parë që dosja e gjykatës përmban aktvendimin e prokurorit special me fillim të hetimit, të datës 17.06.2010 dhe që hetimi ishte vazhduar ligjshmërisht nga gjyqtari i procedurës paraprake deri më 17.06.2011. Prandaj është evidente që aktakuza ishte lëshuar nga prokurori special dhe dorëzuar në gjykatë para skadimit të hetimit.
13. Në çdo rast, është mendimi i këtij Gjyqtari për Konfirmim që korniza kohore e paraparë në nenin 225 të KPPK-së është vetëm në lidhje me mbledhjen e dëshmive dhe jo në paraqitjen e aktakuzës që nuk është veprim hetimor *strictu sensu*. Prandaj, aktakuza mund të paraqitet bile edhe pas periudhës maksimale të aprovuar për hetim ka skaduar.
14. Aktakuza ishte paraqitur në mënyrë të duhur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë (neni 316, par.(3) i KPPK-së). Në fakt në bazë të kompetencës lëndore të gjykatës (neni 23 nën paragrafi 1) pika i) e KPPK-së), është vlerësuar që akuzat janë të ndërlidhura me veprat penale duke lejuar burgimin mbi pesë vjet. Si kompetencë territoriale e gjykatës (neni 27, par.(1) i KPPK-së), sjelljet e përshkruara në aktakuzë kanë ndodhur në Prishtinë.
15. Prandaj, të dyja, kompetenca lëndore dhe territoriale, i përket Gjykatës së Qarkut të Prishtinës.
16. Duke pasur parasysh shqyrtimet e mësipërme, Gjyqtari për Konfirmim ka të drejtë të vazhdojë në shqyrtim të mëtutjeshëm të aktakuzës sa i përket mjaftueshmërisë së dëshmisë për të mbështetur dyshimin e bazuar që të pandehurit kanë kryer veprat penale (neni 316, par.(1) nën parag.4) i KPPK-së).

#### *E. Dyshimi i bazuar*

17. Koncepti i 'dyshimit të bazuar' para supozon ekzistimin e fakteve apo informatave që do të kënaqshin vëzhguesin objektiv që personi në fjalë *mund* të ketë kryer veprën penale.<sup>5</sup>  
Neni 316 par.(1) nën par.4) i KPPK-së kërkon më tepër: 'dyshimi i bazuar' që i pandehuri ka kryer veprën penale që do të thotë që duhet të ketë gjasa reale sa i përket fajësisë të pandehurit, megjithëse ligji nuk e kërkon atë dëshmi të plotë, sigurohet nga prokurori.

<sup>5</sup> *Shih, p.sh.*, Gjykatën evropiane të Drejtave të Njeriut, *Rasti I Fox, Campbell dhe Hartley v. Mbretëri e Bashkuar*, Aktgjykim 30.08.2011, par.32

18. Në bazë të shqyrtimeve të sipërpërmendura, pikat në aktakuzë më tutje janë vlerësuar.

*E.1. Pika 1, Mashtrimi*

19. Në bazë të pikës 1, më 25.11.2008, **Ismet BOJKU** si përfaqësues i të dyja kompanive Dardafon LLC dhe Dardafon.net LLC, paraqiti kërkesë në Agjencinë e Rregullatorit të Telekomunikimeve (ART) për bartje të licencës ORRMV nga Dardafon LLC në Dardafon.net LLC.

Aktakuza pohon që **Ismet BOJKU** në mënyrë të pavërtetë i ka deklaruar ART që bartja e licencës ORRMV ishte bazuar në marrëveshjen e aksionarit kryesor të Dardafonit LLC që ishte UNITEL World Inc (në atë kohë e tëra me pronësi nga Unifi Holdings kryesues i të cilit ishte Adrian Shatku). Si rezultat i bartjes të licencës MVNO, Dardafon LLC humbi licencën MVNO në të cilën kishte investuar EUR 50 000. Aktakuza pohon që sjellja e mësipërme ishte ndërmarrë nga **Ismet BOJKU** në bashkë kryerje me **Blerim DEVOLLI** dhe **Shkelqim DEVOLLI**.

20. Sa i përket pikës 1, është vlerësuar që elementi objektiv i mashtrimit, është definuar në nenin 261 të KPK-së, kërkon që personi tjetër të mashtrohet me përfaqësim të rrejshëm dhe që përfaqësimi i rrejshëm mund të shkaktojë dëm në pasurinë e viktimës.

Si dyshim i bazuar sa i përket ekzistimit të paraqitjes së rreme mund të argumentohet nga letra e nënshkruar nga Adrian Shatku dhe Asheen Aggarwal (të cilët së bashku zotëronin 58% të Dardafon LLC) dhe të adresuar Rexhë Gjonbalaj. Letra tregon që negociatat e bëra nga Devolli Company (e cila zotëronte 42% të Dardafon LLC) me PTK-në pas lidhjes së 'Drejtuesit e Marrëveshjes' (marrëveshja paraprake ndërmjet Dardafon LLC dhe PTK-së sa i përket licencës ORRMV) ka ndodhur pa pëlqimin e tyre dhe pa qenë ata të informuar.

21. Lidhur me këtë çështje, aktakuza (aktakuza § 33, 51) parasheh që **Ismet BOJKU** ka bërë kërkesë në ART në emër të dyja kompanive, Dardafon LLC dhe Dardafon.net LLC. Në kërkesën e ART-së, **Ismet BOJKU** paraqiti që bartja e licencës ishte bërë për qëllime të markës (aktakuza § 33). Siç është shqyrtuar nga gjykata, kërkesa mbi bartjen e licencës ORRMV, e datës 25.11.2008, në të vërtetë bart emrin e nënshkruar të **Ismet BOJKUT** dhe parashikon që bartja e licencës ishte kërkuar në bazë të strategjisë së markës.<sup>6</sup>

22. Duke e bërë kërkesën e mësipërme tek ART, **Ismet BOJKU** ka krijuar paraqitje të rreme që përmbajtja aktuale e kompanisë Dardafon LLC ishte të tjetërsoj licencën e saj ORRMV në Dardafon.net LLC (derisa ky qëllim nuk ka ekzistuar sikurse rezulton nga letra e sipërpërmendur).

Përveç letrës së mësipërme, gjithashtu shqyrtimet në vijim tregojnë që Dardafon LLC nuk ka pasur ndonjë qëllim të jap licencën e saj dhe që **Ismet BOJKU** nuk vepronte në pajtim me mandatin e tij si person përgjegjës i kompanisë së përmendur:

<sup>6</sup> Kërkesë për aprovim të bartjes së licencës, nga Dardafon LLC dhe Dardafon .net LLC, e datës 25.11.2008 (dosja e dëshmisë 1, f.E54)

- Më 22.10.2007, Dardafon LLC paraqiti kërkesë për licencë individuale në ART.<sup>7</sup> Kërkesa propozonte të ndërtoj shërbime të brendshme dhe të jashtme ORRMV bazuar në rrjetin Vala.
- Fatura e ART-së nr.0013-2008, e datës 02.06.2008, për pagesë të taksës të licencës ORRMV EUR 50 000 iu ishte lëshuar Dardafon LLC.
- Më 12.06.2008, licenca MVNO iu ishte aprovuar Dardafon LLC për një periudhë prej 15 vjetëve.<sup>8</sup>
- Më 27.08.2008, Dardafon LLC lidhi me PTK-në 'Drejtuesit e Marrëveshjes'. Në 'Drejtuesit e Marrëveshjes' ishte paraparë që marrëveshja e caktuar do të negociohet ndërmjet palëve (*id est* Dardafon LLC dhe PTK) më 01.10.2008.<sup>9</sup>
- Në bazë të klauzolës 2.f të 'Drejtuesve të Marrëveshjes', marrëveshja ishte personale tek dy palët, Dardafon LLC dhe PTK dhe asnjë nga ata nuk kishin të drejtën të caktojnë apo bartin ndonjë të drejtë nën 'Drejtuesit e Marrëveshjes'.

23. I sipërpërmenduri sugjeron që Dardafon LLC kishte planifikuar të zhvilloj aktivitetin e vet komercial bazuar në licencën e saj ORRMV dhe ka shumë gjasa që bartja e licencës ishte strategji aktuale e Dardafon LLC dhe e shumicës së aksionarëve të saj. Veç kësaj është e rëndësishme që duke bartur licencën (në mënyrë të qartë pa marrë ndonjë pagesë nga Dardafon.net LLC) kompanisë Dardafon LLC iu janë marrë asetet pa ndonjë pëlqim nga aksionarët kryesorë, pa qenë ata në dijeni për atë (dhe në fakt asnjë shumë e të hollave si ishte dhënë Dardafon LLC për bartje të licencës).

24. Përfshirja e **Shkelqim DEVOLLIT** dhe **Blerim DEVOLLIT** në veprën e pretenduar të **mashtrimit** është vlerësuar si në vijim:

- Kërkesa në ART në bartjen e licencës ORRMV ishte bërë në emër të dyja kompanive, Dardafon LLC dhe Dardafon.net LLC.
- Kërkesa ishte paraqitur më 25.11.2008. Dardafon.net LLC kishte hyrë në regjistrin e biznesit kosovar vetëm katër ditë më herët, më 21.11.2008;<sup>10</sup>
- Njëri nga themeluesit të Dardafon.net LLC ishte **Shkelqim DEVOLLI**, në atë kohë duke mbajtur 90% të pjesës së kapitalit.
- Si e tillë, duhet të arrihet në përfundim që **Shkelqim DEVOLLI** themeloi Dardafon.net LLC me qëllim të marrjes së licencës MVNO nga Dardafon LLC. **Shkelqim DEVOLLI** ishte në pozitë të emëroj **Ismet BOJKUN**, si përfaqësues të autorizuar Dardafon.net LLC, kështu që ky i fundit mund të paraqiste kërkesë për bartje të licencës, gjithashtu derisa ishte në mbajtje të pozitës në Dardafon LLC.
- **Blerim DEVOLLI** ishte drejtor ekzekutiv i Dardafon.net LLC dhe **Ismet BOJKU** personi i saj përgjegjës.

<sup>7</sup> Kërkesë për licencë individuale, 22.10.2007 (dosja e dëshmisë 1, pp.E2, E3)

<sup>8</sup> Autoriteti Rregullativ I Telekomunikimeve, licenca për operatorin e rrjetit mobil virtual, 12.06.2008 (dosja e dëshmisë 1, f.E38-E49)

<sup>9</sup> 'Drejtuesit e Marrëveshjes', 27.08.2008, ndërmjet Dardafon LLC and PTK, klauzola 2.c

<sup>10</sup> Agjencioni I Regjistrimit të Biznesit Kosovar, certifikata e regjistrimit, biznesi nr.70540878, Dardafon.net LLC, I datës 21.11.2008 (dosja e dëshmisë 1, f.E55)

25. Pastaj, siç rrjedh nga deklarata e **Blerim DEVOLLIT** në PSRK, aktiviteti biznisor ishte një lloj aktiviteti i familjes DEVOLLI dhe që sa i përket atij biznesi ai dhe vëllai i tij **Shkelqim DEVOLLI** 'janë së bashku'.<sup>11</sup> Prandaj, është e pa mendueshme që ai nuk ishte përfshirë në transaksionin e sipërpërmendur.
26. Në seancën e konfirmimit më 27.10.2011, mbrojtja e **Blerim DEVOLLIT**, **Shkelqim DEVOLLIT** dhe **Ismet BOJKUT** shprehën që pika 1 do të ishte kontradiktore gjithashtu për shkak të mos ekzistimit të palës së dëmtuar. Me të vërtetë, ka gjasa që Dardafon LLC nuk do të sjell ndonjë kërkesë pasurore juridike kundër të pandehurve, pasi që pronarët e Dardafon LLC duket të jenë tani vëllezërit Devolli.  
Konflikti i hapur i interesit mund të zgjidhet me kolegji të seancës kryesore duke emëruar një përfaqësues të autorizuar sipas nenit 82 të KPPK-së.  
Pasi që zbatimi i dispozitës së mësipërme duhet të jetë analogjike (rasti i konfliktit të interesit nuk paraqitet të jetë e rregulluar me nenin 82), ky Gjyqtar i Konfirmimit preferoi që të lë çështjen e mësipërme për kolegjin e seancës kryesore.  
Në çdo rast, Dardafon LLC në një person të personit të saj përgjegjës (apo përfaqësuesi i autorizuar) është me të vërtetë palë e dëmtuar në rastin aktual.
27. Më pastaj, në fund të procedurës së konfirmimit, mund të thuhet që gjithashtu Adrian Shatku dhe Asheen Aggarwal duhet të konsiderohen palët të dëmtuara sa i përket veprës penale të Mashtrimit pasi që të drejtat e tyre ishin rrezikuar dhe/apo shkelur me vepër penale.  
Cdo marrëveshje eventuale dhe vijuese ndërmjet vëllezërve Devolli dhe palëve të dëmtuara nuk ndryshojnë ndonjë gjë sa i përket mundësisë për të ndjekur veprën penale më lartë, pasi që, ndryshe nga shtetet tjera të cilat kërkojnë së paku kërkesën e palës së dëmtuar për të ndjekur keqbërësin, në pajtim me KPK krimi i Mashtrimit duhet të ndiqet *ex officio*.
28. Kështu që, është vendosur sikurse në dispozitiv.

## *E 2. Pika 2, Lidhja e Kontratave të Dëmshme*

29. Sa i përket akuzës së Lidhjes së Kontratave të Dëmshme, në kundërshtim me nenin 237, par.(1), (2) dhe nenit 23 të KPK, është e pakontestueshme që kërkesa në ART, e datës 25.11.2008, kërkoi licencën e ORRMV që të bartej nga Dardafon LLC në Dardafon.net LLC. Mbrojtja e **Ismet BOJKU** argumentoi që asnjë kontratë nuk është nënshkruar nga **Ismet BOJKU** dhe që kërkesa në ART nuk mund të definohet si kontratë sipas nenit 237 të KPK-së.
30. Lidhur me këtë çështje, është vlerësuar nga Gjyqtari për Konfirmim që me të vërtetë kërkesa sa i përket bartjes së licencës ORRMV është pasojë e nevojshme e transaksioneve të

---

<sup>11</sup> PSRK, procesverbali dëgjimit të të dyshuarit, 22.12.2010, Blerim Devolli, f.11 (në versionin në Anglishte) (dosja e dëshmisë 6a, f.F11)

mëhershme (dhe prandaj kontrata) ndërmjet Dardafon LLC dhe Dardafon.net LLC me të cilën licenca ORRMV ishte bartur nga një kompani në tjetrën.

31. sa i përket pasojave për Dardafon LLC në humbjen e licencës ORRMV , konsiderohet që me bartjen e licencës ORRMV në Dardafon.net LLC, Dardafon LLC me siguri humbi taksen e paguar EUR 50 000 (në bazë të urdhrin të pagesës bankare të datës 06.03.2008, taksa e licencës EUR 50 000 është paguar nga Dardafon LLC)<sup>12</sup> dhe gjithashtu ka shumë gjasa fitimet që mund të merren përmes shfrytëzimit komercial të licencës ORRMV.  
Siç është vërejtur tashmë, çuditshmërisht nuk ka pasur pagesë për Dardafon LLC nga Dardafon.net LLC në lidhje me bartjen e licencës.  
Prandaj kontrata ishte e dëmshme për Dardafon LLC.
32. Është e pakontestueshme që **Ismet BOJKU** ka nënshkruar kërkesën në ART mbi bartjen e licencës ORRMV në emër të Dardafon LLC dhe Dardafon.net LLC. Ai me siguri e ka ditur që kjo do të rezultonte në dëm për Dardafon LLC. Sa i përket vëllezërve Devolli, pasi që ata kanë qenë pronarët e 90% të Dardafon.net LLC, ata qartazi ishin përfituesit e tërë operacionit komercial dhe për këtë është e pabesueshme që ata nuk kanë qenë të vetëdijshëm për dëmin e shkaktuar Dardafon LLC. Në të kundërtën, duhet të supozohet që ata ishin organizatorët pas tërë operacionit.
33. Kështu që është vendosur sikurse në dispozitiv.  
*E.3. Pika 3, Keqpërdorim i Besimit*
34. Sa i përket pikës së mësipërme, sjellja tashmë e përshkruar e ndërmarrë nga Ismet Bojku (në bashkë kryerje me vëllezërit Devolli) me të vërtetë paraqet shkelje të obligimit të tij *bona fide* ndaj kompanisë Dardafon LLC të cilës iu ishte marrë licenca ORRMV.  
Sjellja e mësipërme tashmë është dënuar në aktakuzë në lidhje me veprën penale të Mashtrimit.
35. Prandaj, pasi që veprat penale të Mashtrimit dhe Keqpërdorimit të Besimit mbrojnë interesat e njëjta (që është pronësia, pasi që është bërë e qartë nga titulli i kapitullit XXIII të KPK) dhe sjellja e marrë parasysh në aktakuzë për të dyja veprat penale është saktësisht e njëjtë, vepra penale e Keqpërdorimit të Besimit, që është e dënueshme me butë, duhet të konsiderohet e përvetësuar nga vepra penale e Mashtrimit.
36. Në fakt, megjithëse principi i emrit *ne bis in idem* nuk është i paraparë në KPK, duhet të konsiderohet si parim i përgjithshëm, immanent në të gjithë sistemet penale moderne, dhe për këtë i aplikueshëm bile edhe pa dispozitë të veçantë.  
Në bazë të parimit të mësipërm është e ndaluar të ngarkosh keqbërësin e njëjtë më shumë se një herë me faktin e njëjtë: në rast se për faktin e njëjtë dy dispozita penale janë të aplikueshme, vetëm ajo që parasheh dënimin më të rëndë do të aplikohet.

---

<sup>12</sup> Ref. FT0815504103, e datës 06.03.2008 (dosja e dëshmisë 1, f.E52)

37. Për këtë është vendosur sikurse në dispozitiv.

*E. 4. Pika 4, Falsifikimi i dokumenteve*

38. Në pikën 4 të aktakuzës është pohuar që **Blerim DEVOLLI, Shkelqim DEVOLLI** dhe **Ismet BOJKU** në një vend dhe kohë të papërcaktuar në vitin 2008 apo 2009 patën ndikim në hartimin e marrëveshjes finale ORRMV ndërmjet PTK-së dhe Dardafon.net LLC apo hartuan formulimin vetë, përkundër asaj që e dinin që faktet e gabuara ishin deklaruar në dokument. Në veçanti, marrëveshja ORRMV deklaronte që 'Drejtuesit e Marrëveshjes' ishte lidhur ndërmjet PTK dhe Dardafon.net LLC ndërsa është e pakontestueshme që 'Drejtuesit e Marrëveshjes' ishte lidhur ndërmjet PTK dhe Dardafon LLC më 27.08.2008.

39. Mbrojtja pohoi që çfarë kishte ndodhur ishte aktualisht vetëm gabim dhe për këtë nuk ishte kryer asnjë veprë penale, pasi që nuk kishte qëllim për të kryer atë (siç është e njohur mirë, vepra penale e falsifikimit të dokumenteve nuk mund të kryhet me një gabim të thjeshtë, por domosdo kërkon qëllimin e kryerjes së tij).

40. Megjithatë që skenari i alternativës në mënyrë të mjaftueshme nuk e kundërshton lëndën e ndjekjes, pasi që zëvendësimi në marrëveshjen e fundit ORRMV të Dardafon LLC me Dardafon.net LLC pasi që kompania e përmendur në "Krerët e Marrëveshjes" ishte instrumentale në mashtrimin e përmendur më lartë kundër Dardafon LLC. Shqyrtimet e mësipërme na qojnë tek përfundimi i vetëm i mundshëm që me siguri tre të pandehurit (megjithëse nuk është e specifikuar materialisht kush e ka ndërmarrë veprimin) ose e ka hartuar deklaratën e gabuar apo ka pasur ndikim në hartimin e dokumentit. Në çdo rast është e pakontestueshme që dokumenti falsë (që do të thotë marrëveshja e fundit ORRMV ndërmjet PTK-së dhe Dardafon.net LLC) ishte hartuar duke pasur tregues të gabuar që 'Krerët e Marrëveshjes' ishte lidhur me Dardafon.net LLC.

41. Prandaj ekzistimi i dyshimit mirë të bazuar që krimi ishte kryer nga tre të pandehurit mund të konfirmohet.

Me qëllim të arritjes tre fish të dëshmisë së plotë, prokurori duhet të dëshmoj më me saktësi (për shembull duke shqyrtuar njerëzit të cilët morën pjesë në hartimin e marrëveshjes, në veçanti Genc Limani dhe Sebahedin Ramaxhiku), sjellja materiale e cila i ka qar në falsifikimin e mësipërm.

42. Për këtë është vendosur sikurse në dispozitiv.

*E.5. Pika 5, Krimi i Organizuar*

43. Pika 5 akuzon **Blerim DEVOLLI, Shkelqim DEVOLLI** dhe **Ismet BOJKU** me veprë penale të krimit të organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par.(1), (3) dhe nenin 23 të

KPK. Në veçanti, në bazë të aktakuzës, të pandehurit kishin krijuar grupin e strukturuar me qëllim të kryerjes së krimeve serioze.

44. Siç vijon nga neni 274 par.(7) nën par.4) i KPK, është element i domosdoshëm i ‘grupit kriminal të organizuar’ që grupi *nuk është* formuar rastësisht për kryerje të *menjëhershme* të veprës. Kjo do të kërkonte një shoqëri *stabile*, që është kritikuar me qëllim të kryerjes së një apo më shumë krime serioze. Siç vijon nga pretendimet në pikat 1 dhe 2, të pandehurit kanë vepruar në mënyrë të përbashkët në veçanti në lidhje me bartjen e licencës ORRMV nga Dardafon LLC në Dardafon.net LLC. Qëllimi penal i pretenduar duket të jetë i kufizuar në veprimin e mësipërm.
45. Nuk ka tregues që grupi ekzistonte më herët dhe pas kryerjes së veprave penale më lartë. Fakti që Dardafon.net LLC vazhdon të ekzistoj si kompani e biznesit në vetë nuk është e mjaftueshme të marrë konkluzionet në ekzistimin e grupit të strukturuar operativ për një periudhë kohore.
46. Për arsyet e mësipërme Gjyqtari i Konfirmimit konstaton që dyshimi i bazuar mirë trefish për akuzë të krimit të organizuar në pikën 5 të aktakuzës nuk plotësohet.
47. Për këtë është vendosur sikurse në dispozitiv.

#### *E.6. Pika 6, Lidhja e Kontratave të Dëmshme*

48. Sipas aktakuzës, **Rexhe GJONBALAJ**, si kryesues i Bordit të Drejtorëve të PTK-së (organi përgjegjës për menaxhimin dhe udhëheqjen e punëve biznesore të PTK-së), më 20.10.2008, votoi në favor të PTK duke hyrë në marrëveshje ORRMV me Dardafon LLC, megjithatë marrëveshja e mësipërme përmbante në profit të pafavorshëm të ndarë për PTK-në.
49. Para se gjithashtu duhet të merret parasysh që dëshmia tregon që gjithashtu ndarja e të ‘të ardhurat’ janë shqyrtuar nga bordi. Sikurse është e ditur mirë, fjalët ‘të ardhura’ dhe ‘profit’ kanë domethënie të ndryshme, me implikime të ndryshme financiare. Veç kësaj marrëveshja finale ORRMV e datës 16.09.2009, parasheh që ‘të ardhura’ të ndara ndërmjet PTK-së dhe Dardafon.net LLC (Klauzola 7). Dallimi i mësipërm duhet të kihet në mendje në vlerësimin e pikës 6 dhe pikave në vijim të aktakuzës.
50. Në takimin e Bordit të PTK-së, më 14.08.2008, **Rexhe GJONBALAJ** propozoi që Grupi Punues (i ashtuquajtur Task Force I) të formohet për të elaboruar propozimin për ORRMV<sup>13</sup> **Rexhë GJONBALAJ** propozoi që drejtorit ekzekutiv Adnan Merovci ti besohet për të formuar Grupin Punues I.<sup>14</sup>

<sup>13</sup> PTK, procesverbali i takimit nr.4 të bordit të drejtorëve, më 14.08.2008 (dosja e dëshmisë 2, pp.C2, C3)

<sup>14</sup> PTK, minutes of the meeting no.4 of the board of directors, on 14.08.2008 (evidence binder 2, p.C2)

51. Është e pakontestueshme që në takimin e bordit më 02.10.2008, Genc Lami, njëri nga anëtarët e Grupit Punues I, tregoi që Dardafon LLC kishte bërë dy propozime:  
I pari i dha Dardafon LLC 70% dhe PTK 30% të të hyrave neto ndërsa i dyti i caktonte Dardafon LLC 80% dhe PTK-së 20% të të hyrave bruto.  
Kushtet e ORRMV e propozuara PTK-së janë diskutuar më tutje: Afrim Bejtullahu, njëri nga anëtarët e Grupit Punues I, i shpjegoi Bordit të drejtorëve që Grupi Punues I i kishte definuar hisen e PTK-së ndërmjet 20% - 30%.<sup>15</sup>
52. Pasi që disa anëtarë të bordit të PTK-së shprehen brengat e tyre sa i përket konstatimeve të Grupit Punues I, një grup tjetër punues (i ashtuquajtur Task Force II) ishte formuar. Grupi Punues II konsideroi që pjesa a të ardhurave – PTK 22% dhe dardafon LLC 78% - ishte e dëmshme për PTK-në dhe që përqindja e pjesës është dashur të jetë 73% për PTK-në dhe 27% për Dardafon LLC.<sup>16</sup>
53. Pa marrë parasysh për këto konstatime të Grupit Punues II, **Rexhe GJONBALAJ** në takimin e bordit më 20.10.2008 kërkoi nga bordi mbështetje të marrëveshjes ORRMV, me përqindje 22% për PTK-në dhe Dardafon LLC 78% dhe votoi në favor të saj.<sup>17</sup>
54. Në intervistë të PSRK-së **Rexhe GJONBALAJ** konfirmoi që ai dinte për ekzistimin e Grupit Punues II dhe për konstatimet e tij. Megjithatë, në bazë të **Rexhe GJONBALAJ**, bordi i PTK-së besoi që qëllimi i Grupit Punues II ishte dështimi i projektit.<sup>18</sup>
55. Sjellja e **Rexhe GJONBALAJ** duket të jetë shumë bizare. Në veçanti, është e çuditshme dhe e dyshimtë që ai e shtyu bordin me qëllim të votimit në favor të propozimit të Grupit Punues I, që ishte qartazi më pak i favorshëm për PTK-në (pjesa interesat e të cilëve do të duhet të kujdeseshin nga i pandehuri).  
E njëjta mund të thuhet në lidhje me **Shyqyri HAXHA** i cili nënshkroi marrëveshjen ORRMV në emër të PTK-së. Megjithëse ai vendosi të ngrit pjesën e PTK-së në 27%, duket bizare dhe e dyshimtë që ai vendosi të nënshkruaj marrëveshjen pa marrë parasysh konstatimet e Grupit Punues II, që ishin më të favorshme për PTK-në.
56. ËSHTË e pakontestueshme që **Shyqyri HAXHA**, në nënshkrimin e marrëveshjes ORRMV, veproi në bazë të vendimit të bordit të PTK-së. **Rexhe GJONBALAJ** në intervistën e PSRK-së njoftoi që ajo ishte pjesë e detyrave të **Shyqyri HAXHA** të negociojë kontratën me Dardafon LLC bazuar në vendimin e bordit të PTK-së.<sup>19</sup>  
Vendimi i PTK-së i datës 20.10.2008, qartazi tregonte që marrëveshja ORRMV me Dardafon LLC ishte aprovuar.

<sup>15</sup> PTK, procesverbal I takimit nr. 7 të bordit të drejtorëve, më 02.10.2008 (dosja e dëshmisë 2, pp.F2-F5)

<sup>16</sup> PTK, letra e bordit të drejtorëve, 20.10.2008 (dosja e dëshmisë 2, p.IJ17)

<sup>17</sup> PTK, procesverbal I takimit nr. 15 të bordit të drejtorëve, më 20.10.2008 (dosja e dëshmisë 2, pp.IJ1-IJ5)

<sup>18</sup> PSRK, procesverbal I hetimit të të dyshuarit 10.02.2011, Rexhe Gjonbalaj, pp.8, 9 (në verzionin në anglisht) (dosja e dëshmisë 6a, pp.A8, A9)

<sup>19</sup> PSRK, procesverbal I shqyrtimit të dyshuarit, 10.02.2011, Rexhe Gjonbalaj, p.15 (në verzionin në Anglisht) (dosja e dëshmisë 6a, f.A15)

**Shyqyri HAXHA** pa që bordi i PTK-së kishte autorizuar marrëveshjen ORRMV me Dardafon LLC por, pavarësisht nga kjo, lidhi marrëveshjen ORRMV me një kompani tjetër Dardafon.net LLC.

Më pastaj ai nënshkroi një marrëveshje ORRMV duke i caktuar PTK-së një pjesë shumë më të vogël sesa ajo e sugjeruar nga Grupi Punues II.

57. **Shyqyri HAXHA** deklaroi në PSRK që pas leximit me vëmendje vendimin e ART-së, të datës 10.07.2008, ai konkludoi që Dardafon LLC dhe Dardafon.net LLC ishin kompania e njëjtë.<sup>20</sup>

Megjithatë, ka shumë pak gjasa që ai ka mundur të bëjë një gabim të tillë: në fakt nga preambula e vendimit të ART-së, të datës 10.07.2008, vijon që vendimi i ART-së ishte lëshuar pas kërkesës për *bartje* të licencës ORRMV . fjala '*bartje*' nënkupton që licenca iu ishte dhënë nga njëra në kompaninë tjetër, duke e bërë të qartë që kompanitë e përfshira ishin dy. Më pastaj, vendimi i ART-së, i datës 10.07.2008, emri i Dardafon.net LLC dhe numri i saj i regjistrimit ishin përmendur, duke e bërë të qartë që kjo e fundit ishte kompani ndryshe nga Dardafon LLC.

I pandehuri është person me arsimim të lartë, me përvojë në aktivitetin e biznesit dhe për këtë është e pa mendueshme që ai se kuptoi që Dardafon LLC dhe Dardafon.net LLC janë dy kompani të ndryshme.

Më pastaj, pasi që i pandehuri ia doli të ngrit pjesën për PTK nga 22% në 27%, duket që ai nuk ishte i detyruar me vendim të bordit (së paku sa i përket aksioneve). Prandaj, ai ka mundur të marrë parasysh rezultatet e Grupit Punues II, por ai nuk e ka bërë këtë.

58. Ky gjyqtar për konfirmim konfirmon që një ekspertizë e plotë financiare duhet të kryhet në fazën e shkallës së parë, me qëllim të marrjes së mendimit të ekspertit sa i përket dëmit të marrëveshjes. Në anën tjetër, marrëveshja e fundit ORRMV dhe vendimi i bordit duket qartazi në kontrast me interesin e PTK-së dhe qon në konkludim që kontrata ishte e dëmshme për PTK-në.

59. Zhurma e madhe ndërmjet pjesës së PTK-së që ishte mbështetur nga **Rexhe GJONBALAJ** (22%) dhe **Shyqyri HAXHA** (27 %) dhe pjesa e këshilluar nga Grupi Punues II (së paku 73%) e bën të qartë që të dy të pandehurit e kanë ditur që marrëveshja e fundit ORRMV do të shkaktonte dëm për PTK-në, por pa marrë parasysh këtë, vendosi të shkojë më tutje. Arsyetja e kësaj sjelljeje nuk është sqaruar nga hetimi, por sidoqoftë dëmi i votuesve të kontratës dhe për këtë mund të përfundojë që ka dyshim mirë të bazuar sa i përket kryerjes së veprës penale.

60. Prandaj aktakuza duhet të konfirmohet sikurse në pikën 6.

#### *E.7. Pika 8 kundër Shyqyri HAXHA dhe pika 9 kundër Rexhe GJONBALAJ*

<sup>20</sup> PSRK, procesverbal I dëgjimit të dyshuarit, 20.12.2010, Shyqyri Haxha, pp.23 (në verzionin në Anglisht) (dosja e dëshmisë 6a, p. H23)

*Keqpërdorim i Autorizimeve në Ekonomi*

61. Pasi që sjellja i atribuonte të pandehurve sa i përket dy pikave më lartë është e ngjashme tashmë e përshkruar në lidhje me veprën penale të Lidhjes së Kontratave të Dëmshme (pika 5) dhe pasi që dy dispozitat (neni 236 dhe 237 i KPK-së) mbrojnë interesat e njëjta (kujdestari i sistemit ekonomik drejtësia në raportet ekonomike sikurse është bërë e qartë nga titulli i kapitullit XXII të KPK-së), për arsyet tashmë të sqaruara më lartë në lidhje me pikën 3, vepra penale e Keqpërdorimit të Autorizimeve në Ekonomi duhet të konsiderohet e përvetësuar nga vepra më e rëndë e Lidhjes së Kontratave të Dëmshme, në pajtim me tashmë parimin e kërkuar të emrit *ne bis in idem*.
62. Për këtë është vendosur sikurse në dispozitiv.

*E. 8. Pika 7 kundër Shyqyri HAXHA dhe pika 10 kundër Rexhe GJONBALAJ*  
*Shpërdorim i pozitës zyrtare*

63. Është e pakontestueshme që PTK është Ndërmarrje me Pronësi Publike, sipas Ligjit Nr. 03/L-087, dhe që të dy të pandehurit (**Rexhe GJONBALAJ** si kryesues i bordit të drejtorëve të PTK-së, **Shyqyri HAXHA** si Kryeshf Ekzekutiv i PTK-së) k ushtruar në rastet e përshkruara në aktakuzë detyra specifike zyrtare bazuar në autorizimin e dhënë nga ligji më lartë. Prandaj, sipas nenit 107, par. (1), pika 3) e KPK-së, të dy nga ata janë persona zyrtarë.
64. Pas qartësimit të asaj, tashmë të përshkruar sjelljen e ndërmarrë nga të pandehurit në lidhje me votimin e marrëveshjes ORRMV me ndarje të pa favorshme për pjesën për PTK-në (**Rexhe GJONBALAJ**) dhe nënshkrimin e marrëveshjes me Dardafon.net LLC (**Shyqyri HAXHA**) gjithashtu janë relevante në lidhje me nenin 339 të KPK-së. Në fakt, sjelljet në fjalë tregojnë që të pandehurit, si persona zyrtarë, kanë shpërdoruar pozitën e tyre, me qëllim të bëjnë Dardafon.net LLC të marr përfitim material ilegal (që ishin të dyja, marrjen e licencës ORRMV dhe marrjen e hises me përqindje qartazi të pafavorshme për PTK-në).
65. Vlen të përmendet që sa i përket pikave 7 dhe 10 të parimit të përmendur më lartë të emrit *ne bis in idem* nuk është i aplikueshëm, pasi që dy dispozitat mbrojnë dy interese të ndryshme. Në fakt, neni 236 i KPK mbron drejtësinë në raportet ekonomike, ndërsa neni 339 i KPK mbron korrektësinë dhe paanësinë e administratës publike. Prandaj, megjithëse sjellja është e njëjtë, nuk ka ndeshje të dispozitave dhe nuk mund të thuhet që të pandehurit janë ngarkuar më shumë se një herë me faktin e njëjtë.
66. Është mendimi i gjyqtarit për Konfirmim që duke shtyrë anëtarët e tjerë të bordit për të votuar pa ju dhënë atyre kohë për të kontrolluar konstatimet e Grupit Punues II dhe duke votuar aprovimin e marrëveshjes që u paraqit, *prima facie*, e pa favorshme për PTK-në **Rexhe GJONBALAJ** vërtetë ka shpërdoruar pozitën e tij me qëllim të veçantë për t'i dhënë kompanisë private një përfitim material të paligjshëm.

67. E njëjta mund të thuhet për **Shyqyri HAXHA** i cili vendosi të nënshkruar marrëveshjen e cila ishte e pa favorshme për PTK-në sa i përket pjesës dhe në kundërshtim me obligimin kontraktual të PTK-së ndaj Dardafon LLC. Prandaj është e pakontestueshme që i pandehuri ka shpërdorur pozitën e tij me qëllim të dhënies Dardafon.net një përfitim material ilegal.
68. Përsëri, hetimi nuk ka theksuar se cila ishte arsyeja se pse dy të pandehurit vendosen të marrin qëndrim jo në pajtim me interesat e PTK-së dhe kjo duhet të qartësohet nga seanca kryesore.
69. Për këtë është vendosur sikurse në diapozitiv.

*F. Pranueshmëria e provave*

70. Në seancën e konfirmimit më 27.10.2011 avokati mbrojtës **Ismet BOJKU** dhe **Shyqyri HAXHA** kërkoi që letrat e nënshkruara nga Adrian Shatku, e përmbajtur në dosje të dëshmisë 1, Tab.F, e datës 08.10.2008, 28.07.2009, 11.08.2009, 23.10.2009, 19.03.2010 dhe 16.03.2010, të deklarohet si dëshmi e pranueshme, sipas nenit 154 par.(2) të KPPK-së. Ishte argumentuar që mbrojtja nuk është akorduar me mundësinë e kundërshtimit të Adrian Shatkut sipas nenit 156, par. (2) të KPPK-së.
71. Është vlerësuar nga gjyqtari për konfirmim që letrat në dosje të dëshmisë 1, tab F, në PTK nuk janë deklarata, por saktësisht letra dhe për këtë deklaratat e nënshkruara të cilat duhet të konsiderohen si prova dokumentuese. Pasi që ato dëshmi nuk janë marrë në mënyrë në kundërshtim me dispozitat e KPPK-së, letrat e mësipërme janë të pranueshme dhe duhet të mbetën në dosje të lëndës.
72. Në lidhje me aktivitetet e përgjimeve, Gjyqtari për Konfirmim, sipas nenit 264, par. (3) të KPPK-së, duhet të shqyrtoj *ex officio* pranueshmërinë e dëshmisë së mbledhur. Urdhri i përgjimit i lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake dhe i datës 27.12.2010 përfshiu *inter alia* autorizimin për përgjim të numrave telefonik në vijim:
- X që i përket Z. Ismet Bojkut dhe Z. Blerim Devollit;
- X që i përket Z. Shkëlqim Devollit;
- X që i përket Z. Blerim Devollit.
73. Megjithatë, gjatë aktivitetit të përgjimit, doli që numrat e mësipërm janë përdorur nga njerëzit tjerë nga të pandehurit. Në fakt, në pajtim me raportin policor të Kosovës mbi përgjimet, ref.nr..DHKO/SHFI 03/2011, të datës 11.01.2011:
- numri X ishte përdorur nga X ;
- numri X përdorur nga një person i quajtur X ;
- numri X ishte përdorur nga një person me emër X nga X.

74. Raportet duke pasuar raportin e datës 11.01.2011 konfirmoi vlerësimin fillestar.
75. Pasi që ishte evidente së paku prej 27.01.2011 (prandaj pas një muaji të aktivitetit të përgjimit) që numrat e mësipërm nuk janë shfrytëzuar nga të dyshuarit dhe që njerëzit që përdornin numrat e mësipërm nuk kishin kontakte me të dyshuarit, përgjimet është dashur të ndërkrehen prej asaj dite.
76. Prandaj mund të konkludohet që, duke filluar prej 27.01.2011, zbatimi i urdhrit të mësipërm ishte i paligjshëm dhe dëshmia e marrë pas 27.01.2011 përmes përgjimit të numrat të mësipërm ( X , X , X ) nuk është e pranueshme.
77. Sa i përket numrave të tjerë të përgjuar nuk është gjetur ndonjë arsye e papranueshmërisë.

*G. Mjeti juridik.*

78. Është shumë e kontestueshme pa marrë parasysh nëse ankimohet aktvendimin për konfirmim të aktakuzës. Në njërën anë, dispozita e përgjithshme e paraparë në nenin 431 të KPPK-së deklaron që ankesa kundër aktvendimit të marrë në shkallë të parë është e pranueshme derisa qartazi i ndaluar. Nuk është paraparë ndonjë ndalesë në KPPK-së sa i përket mundësisë për të ankimuar aktvendimin mbi konfirmim.
79. Në anën tjetër, neni 317 i KPPK-së duket të merr në konsideratë vetëm mundësinë e për prokurorin dhe palën e dëmtuar për të ankimuar aktvendimin që e refuzon aktakuzën, duke lejuar interpretimin që asnjë ankesë nuk do të lejohej kundër konfirmimit të aktvendimit.
80. Është mendimi i këtij Gjyqtari Konfirmues që kush mund të jetë vendimtare me qëllim të zgjidhjes kontestin është e vlerësimit sistematik të dispozitave të KPPK-së lidhur me ankesat kundër aktvendimeve. Një vlerësim i tillë qon në konkludim që aktvendimi që konfirmon aktakuzën nuk mund të ankimohet.
81. Në fakt, nëse ne supozojmë që aktvendimi i cili konfirmon aktakuzën është i ankimueshëm, është e pakontestueshme që ankesa duhet të vendoset nga kolegji prej tre gjyqtarëve (neni 317, par. (2) i KPPK-së). Megjithatë, siç është e njohur mirë, sipas nenit 431 par. (431 par.2 i KPPK, asnjë ankesë nuk është e lejuar kundër aktvendimit të marrë nga kolegji prej tre gjyqtarëve.
82. Prandaj skenari në vijim hipotetik ka mund të ndodh: pas konfirmimit të aktakuzës, i pandehuri paraqet ankesë kundër aktvendimit. Ankesa miratohet nga kolegji prej tre gjyqtarëve dhe për këtë aktvendimi fillestar modifikohet dhe aktakuza refuzohet. (neni 434 par. (3) KPPK).

83. Në një skenar të tillë hipotetik prokurori nuk ka mund të të ankmoj aktvendimin e kolegjit prej tre gjyqtarëve me rezultat që aktakuza do të refuzohej pa mundësinë për prokurorin të ankohet (mundësia e cila është, në të kundërtën, e aprovuar kur refuzimi i bërë nga gjyqtari për konfirmim).  
Do të ishte e çuditshme e cila do të merrte sistemin absurd dhe do të lente prokurorin pa ndonjë mundësi të ankimoj vendimin që e refuzon aktakuzën.
84. Prandaj, duket që mundësia për të pandehurin të ankimoj aktvendimin i cili konfirmon aktakuzën do të çonte në një disbalancë ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes.  
Është me rëndësi për të përmendur që gjithashtu në sistemet e tjera (për shembull në Itali) i pandehuri nuk mund të ankimoj aktvendimin të gjyqtarit që vendos pa marr parasysh nëse do të ketë seancë kryesore pas aktakuzës së paraqitur nga prokurori. Kështu, fakti që i pandehuri nuk mund të ankimoj konfirmimin e aktvendimit nuk mund të konsiderohet si e çuditshme.
85. Është me rëndësi për të përmendur që nuk mund të kërkohet ndonjë dëm nga mbrojtja në bazë të interpretimit të sipërpërmendur, pasi që i pandehuri, në rast të aktgjykimit të pa favorshëm në seancë kryesore, do të ketë mundësinë të paraqesë ankesë.

Në bazë të mësipërmes, është vendosur sikurse në dispozitiv.

---

Gjyqtari i EULEX-it Gianfranco Gallo  
Gjyqtar për Konfirmim

**Mjeti juridik:** Aktvendimi sa i përket pjesës së saj që e refuzon aktakuzën mund të ankimohet nga prokurori dhe nga palët e dëmtuara në kolegji prej tre gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë brenda tre ditëve të dorëzimit të tij.

Aktvendimi mund të ankimohet sa i përket pjesës së tij lidhur me pranimin e provave në pajtim me nenin 264, të KPPK-së brenda 72 orëve nga dorëzimi i tij.